



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:235130
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05760982

CAP.nr.863/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, në çështjen përmbartimore të kreditores N.N nga Prishtina, të cilin e përfaqëson e autorizuar e saj av. D.K nga Prishtina, kundër debitorit SHSKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës - QKUK, me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditores të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.914/2020, të datës 08.11.2023, me datën 30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditores N.N nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.914/2020, i datës 08.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.914/2020, të datës 08.11.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit SHSKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës - QKUK, me seli në Prishtinë dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.603/20, të datës 10.07.2020, të lëshuar nga përmbartuesi privat H.H, në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit ka anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra në çështjen përmbartimore dhe në pikën III ka specifikuar që secila palë të i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditorja përmes të autorizuarës së saj ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim

që të aprovohet ankesa e kreditores si e bazuar, të anulohet aktvendimi PPP.nr.914/20, i datës 08.11.2023, ashtu që urdhri përbarimor P.nr.603/20, i datës 10.07.2020, të mbetet në fuqi apo të priset aktvendimi i shkallës së parë dhe lënda të kthehet në procedurë të serishme në të njëjtën gjykatë me çka t'i rekomandohet kësaj gjykate, që të caktoj një ekspert financiar për të specifikuar dhe llogaritur pagën e kreditores, ashtu që të obligohet debitori SHSKUK - QKUK në Prishtinë, që në emër të përpilimit të ankesës të paguaj shumën prej 208 euro.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

- ankesa e kreditores, **është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja me datë 10.07.2020, ka parashtruar propozim për lejimin e përbarimit në bazë të titullit ekzekutiv, vendimit të Inspektoratit të Punës nr ..., të datës 02.06.2020, më gjerësisht si në propozimin për përbarim. Përbaruesi Privat H.H ka nxjerr urdhrin P.nr.603/20, të datës 10.07.2020, me të cilin e ka lejuar propozimin për përbarim. Kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit debitori me datë 27.07.2020, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe urdhri P.nr.603/20, i datës 10.07.2020, të anulohet, ndërsa propozimi për përbarim të hedhet poshtë si i pabazë. Kreditori me datë 05.08.2020, ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.914/2020, të datës 08.11.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumenti përbarimor me të cilin është iniciuar procedura përbarimore, respektivisht vendimi i inspektoratit të punës nr ..., të datës 02.06.2020, nuk është i përshtatshëm për përbarim për faktin se në të nuk është përcaktuar shuma e përmbushjes së detyrimit. Tutje ka theksuar se në rastin konkret dokumenti përbarimor nuk përmban elementet konstituive sipas dispozitës së nenit 27 paragrafi 1 të LPP, lidhur me shumën e përmbushjes së detyrimit dhe se në të njëjtin është cekur vetëm çështja lidhur me kompensimin e tri pagave mujore në emër të shpërblimit jubilar, por pa e përcaktuar shumën e atyre pagave. Ashtu që ka shtuar se përbarimi në këtë çështje është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përbarimor, të paraparë me dispozitat e LPP, për faktin se titulli ekzekutiv mbi bazën e të cilit është parashtruar propozimi për përbarim, është i papërshtatshëm sepse nuk e përmban shumën e përmbushjes së detyrimit. Për mënyrën e vendosjes e njëjta i është referuar dispozitës së nenit 27, 71 dhe 73 të LPP.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë

çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit se Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) k) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditores, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartim edhe nga fakti se me nenin 27 paragrafi 1 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbartimor është i përshatshëm për përmbartim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor – vendimi administrativ i inspektoriatit të punës nr ..., i dates 02.06.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë pretendimet e prapësimit të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore, mirëpo të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për shkak se me shikim në shkresat e lëndës vërtetohet se me rastin e parashtrimit dhe lejimit të propozimit për përmbartim i njëjti është lejuar në bazë të vendimit nr ..., të datës 02.06.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartimor.

Duke i vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se pala kreditore as gjatë procedurës e as me ankesë nuk ka propozuar plotësimin e propozimit përmbartimor, andaj dhe gjykata e shkallës së parë sipas prapësimit të debitorit ka qenë e detyruar që të veprojë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë ka vendosur, pasi që ka qenë detyrim i vetë palës kreditore e cila ka interes në këtë procedurë, që paraprakisht të bëjë edhe precizimin dhe korrigjimin e propozimit për përmbartim. Gjykata e Apelit vlerëson se pala kreditore eventualisht mund të parashtrijë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartimor, pasi që në këtë procedurë ka bërë lëshime të cilat e kanë pamundësuar përmbartimin e propozuar.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim

me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.863/2024, me datën 30.05.2024

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj